



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 504/1 prot.

Tiranë, më 13.02.2026

URDHËR

Nr. 38, datë 13.02.2026

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT INSTITUCIONAL TË TRANSPARENCËS TË
ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 4 dhe 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit institucional të Transparencës të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) hartuar në përputhje me Urdhrin nr. 280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit model të Transparencës për autoritetet publike”, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Programi institucional i Transparencës publikohet në faqen zyrtare www.idp.al në menunë “Programi i Transparencës”.
3. Ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe koordinatori për të drejtën e informimit për të bashkërenduar punën për bërjen publike në faqen zyrtare të institucionit të çdo informacioni/dokumentacioni në funksion të transparencës proaktive.
4. Urdhri nr. 32, datë 24.03.2021 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Lidhja nr. 1

PROGRAMI I TRANSPARENCËS I ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Data e përditësimit të fundit:

Përditësuar: __.__.202__

Programi i Transparencës Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		
Rreth Autoritetit	Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian Tekstet e plota	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi KDIMDP	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të KDIMDP	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat
Shërbimet që ofrohen nga KDIMDP	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të KDIMDP	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga KDIMDP	Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga KDIMDP

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), Autoriteti Publik (Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në vijim “Zyra e Komisionerit”) publikon Programin e Transparencës (në vijim “PT”) sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”). Informacioni në PT publikohet i përditësuar, në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit. Në PT janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit, Komisioneri vlerëson nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Zyra e Komisionerit. Nëse Komisioneri nuk ka/zotëron informacione pjesë përbërëse të PT, atëherë bën shënimin përkatës (psh: nuk ka informacion, nuk ofron shërbimin, etj.).

Rreth Autoritetit

- Struktura organizative/Organigrama
- Struktura e pagave
- Funksionet dhe detyrat e KDIMDP
- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të KDIMDP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të KDIMDP për të marrë vendime
- Vendimmarrja e KDIMDP (vendime/rekomandime/urdhra, etj.)
 - Për të drejtën e informimit
 - Për mbrojtjen e të dhënave personale
 - Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit
 - Për njoftimin dhe konsultimin publik
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e KDIMDP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

Kuadri ligjor rregullator dhe integrimi evropian

Tekset e plota

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
 - Legjislacioni për të drejtën e informimit
 - Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale
 - Legjislacioni për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik
 - Legjislacioni për njoftimin dhe konsultimin publik
- Informacion mbi procesin e integritetit evropian
 - Dokumente strategjike për integrimin evropian
 - Raportime mbi zbatimin e detyrimeve në procesin e integritetit evropian
 - Raporte monitorimi, auditimi dhe vlerësimi nga ana e Komisionit Evropian (p.sh. Progres Raporti, etj.)
 - Dokumenta të tjera mbi procesin e integritetit evropian
- Akte nënligjore
 - Për të drejtën e informimit
 - Akte
 - Për mbrojtjen e të dhënave personale
 - Vendime
 - Udhëzime
 - Për ripërdorimin e informacionit publik
 - Akte
- Rregullore
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit*
- Zyra e Komisionerit nuk miraton rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit.
- Strategjia 2022-2025
 - Strategji të përmbushura të KDIMDP
- Raport vjetor
- Plani i Integritetit
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e KDIMDP dhe që prek publikun
 - Udhëzues
 - Opinione
 - Manuale

E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

- Koordinatorit
 - Alketa Koja
- E-mail
 - info@idp.al
- Nr. i gjelbër
 - 08002050
- Tel
 - 042 221956
- Adresa
 - Rr. Abdi Toptani, Nd. 5, kodi postar 1001
- Orari
 - E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30
 - E premte: 08:00 – 14:00
- Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankesë / Shpjeguese (Procedura e ankimit te Komisioneri)

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi KDIMDP

- Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë
- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi (p.sh:KLSH)
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së KDIMDP
 - Raportet e monitorimit financiar të KDIMDP (sipas viteve)

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të KDIMDP

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve)
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)
- Donacione, sponsorizime (sipas viteve)
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara*
- Zyra e Komisionerit nuk tarifton pagesë për shërbimet e saj.

Shënim: Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
 - Regjistri i realizimeve dhe donacionet (sipas viteve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

Shërbimet që ofrohen nga KDIMDP

Lista e shërbimeve:

*që ofron KDIMDP: përfshirë (tarifat, formular aplikimi, afati kohor, procedurë ankimi, standardet për cilësinë e shërbimit):

- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave
- Akreditimi i organizmave të certifikuar

*për të dy procedurat nuk aplikohet asnjë tarifë.

Shënim: Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etj.

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të KDIMDP

- [Njoftimi dhe konsultimi publik](#)
- Planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimarrjes
- Komente/Rekomandime/Opinionet e palëve të interesuara/grupe interesi*
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve*
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes*
- Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të KDIMDP*
- [Emër mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike](#)

Shënim: Zyra e Komisionerit nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

- Lista e dokumenteve që administrohen nga KDIMDP me afatet e ruajtjes
- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

- [Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar](#) (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)

Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga KDIMDP

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga KDIMDP*
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve*
- Procedura për të përfutur ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim*
- Procedura e ankimit*

Shënim: KDIMDP nuk e ofron këtë shërbim.

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga KDIMDP

- [Njoftime të ndryshme](#)
- [Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil](#)
- [Raporte](#)
- [Publikime](#)
- [Statistika](#)
- [Projekte](#)
- [Bashkëpunime etj.](#)

Shënim: KDIMDP vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që merr më shpesh.